



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI BASHKIAK DROPULL

Nr. 957 Prot.

Jorgucat, me 31 /05/2022

PROÇES-VERBAL

TAKIM MË DATË: 31.05.2022

Tema: Mbledhja e Këshillit Bashkiak Dropull,

Të muajit Maj 2022,fillon ne oren 10:00.

Mbledhja Zhvillohet në sallën e mbledhjes të Këshillit,

Mbledhja fillon me Kryetarin e Keshillit znj.Donika Bauçi,kryesuese e mbledhjes.

Keshilltare te pranishem ne mbledhje:Donika Bauçi, Dhimitër Koça ,Maksi Qendro, ,Alketa Basho,Angjeliqi Praso,Kostandina Doku, ,Luljeta Pirali,Elefteria Karanxha. ,Zhaneta Dralo Marjeta Xhumba ,Thodhori Dhima ,Vjoleta Ndrico.

Mungesat:,Elina Dhima,Eljona Mano, Anastas Iso, Llaokrat Konomi,Jorgo Luleme,Vasiliqi Nika, Kristo Varsami, Fotaq Zhonga,

Kryetarja e Keshillit deklaron Kuorumin te hapur me 12 keshilltare:

Fillojme me miratimin e rendit te dites:

Miratojme pikat 1,2 dhe 4 te rendit te dites,pika 3 per mungese dokumentacioni shtyhet per mbledhjen e muajit Qershor.

Ne salle marrin pjese dhe nenkryetarja e Keshillit Angjeliqi Praso(e cila mban procesverbalin e mbledhjes) dhe pergjegjes i zyres se buxhetit z.Lengo.

Kalojme ne piken e pare te rendit te dites

Relaton z.Lengo(drejtuesi i ekipit te menaxhimit te programit)

Cdo keshilltar ka ne dosje raportin e monitorimit te zbatimit te buxhetit per 4 mujorin e vitit 2022.

Ne kete raport jane raporti i shpenzimeve sipas programeve sipas artikujve buxhetor .

Raporti i realizimit te investimeve.me financim te brendshem,raporti I realizimit te te ardhurave dhe realacion shpjegues.

Sfida baze e Bashkise sigurimi i furnizimit me uje te pijshem nepermjet investimeve te ujesjelles kanalizimeve.

Krijimin e kushteve per kthimin e emigranteve . Garantimin e sigurise publike.

Nga ana e GMS e dates 18.05.2022,eshte vleresuar situata aktuale ,eshte raportuar nga drejtuesit e EMP lidhur me monitorimin e zbatimit te buxhetit per 4-mujorin e vitit 2022,duke e krahasuar ate me 4 mujorin e pare te vitit 2021.

Nga krahasimi i bere me vitin e kaluar u pa e nevojsheme marrja e masave dhe veprimeve korigjuese,ne krahasim me vitin 202,nga 1600 leke me teper ,ne tatol realizohen 26% vjetor.

Realizimin e shpenzimeve e paraqesim sipas programeve nga Ekipet e Menaxhimit te Programit dhe Drejtuesit e tyre.

Te rritet shkalla e pergatitjes te dokumenta cionit per te bere te mundur,krijimin e plote te shpenzimeve.Te percaktohen detyrat dhe objektivat konkrete te gjitha programeve buxhetore,dhe ne kuader te hartimit te projekt-dokumentit te pare te PBA –se 2023-2025 ,i cili do te miratohet ne muajin Qershor.

Kryesuese mbledhjes Kryetare Keshillit znj.Donika Bauçi ben pyetje: Pse realizimi te ardhurave eshte shume i ulet kete 4 mujor ?

Pergjigjet pergjegjese e taksave Aleksandra Fero:Familjaret paguajne deri ne fund te Dhjetorit ,do kerkojme me shume llogari, agjenteve dhe inspektoreve tatimor te cilet ndihmojne ne mbledhjen e te ardhurave.

Znj. Donika Bauçi thote :Diskutim ne lidhje me monitorimin e zbatimit te buxhetit nuk ka,vazhdojme me piken 2 te rendit te dites.

Per miratimin e perfituesve te fondit shtese mbi fondin e kushtezuar te ndihmes ekonomike.

Referon z.Kristaq Lengo:Nga listat e ndihmes shtohet Stravulla Vllahana,listat e tjera nuk ndryshojne.

Znj. Donika Bauçi :Hedhim ne vote meqe s'ka pyetje.

Votojne 12 keshilltare pro ,kundera s'ka.

Pra miratohet.

Pika 3 e rendit te dites,per mungese dokumentacioni shtyhet per mbledhjen e muajit Qershor .

Vazhdojme me piken 4 te rendit te dites ,”Per masat dhe parandalimin e shuarjeve te zjarreve”
Fjalën e merr drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë, Pyjeve dhe Kullotave z.Llambi Ngjelo I cili flet për masat dhe programin e punës për parandalimin e zjarreve.

Z.Ngjelo tha:Per rregullat dhe parandalimin e zjarreve dhe kullotave për përballimin e situatave emergjente në DAUPLK ,bashkia Dropull ngriti shtabin qendror i përbërë nga 10 punonjës të Bashkisë i cili bën vlerësimin e situatave të krijuara.

Pyetje nga Z.Dhimiter Koça :perse nuk shtohen punonjës sezonal?

Përgjigjet z.Dhefto:Do caktojme muajin tjetër.

Znj. Donika Bauçi :Hedhim në votë projekt vendimin

Votojnë 12 Keshilltarë.

Kryesuesja e mbledhjes:Eshtë paraqitur një kërkesë për rikonstruksionin e shtëpisë të djegur në fshatin Hllomo.

Përgjigje për kërkeset:

Meqenese kërkeset janë vajzat e trashëgimtareve, të cilët kanë vdekur në mënyrë aksidentale gjatë djegies të banesës,duhet që të paraqesin në Keshill dokumentin e trashëgimit të banesës,për të marrë ndihmën e kërkuar.

Kërkesë e z.Mihal Curi,fshati Dervician,për hapjen e një rruge që ndodhet pranë banesës të tij në fshatin Dervician.

Në sallë ndodhet kërkesi i cili e parashtron kërkesën e tij me gojë.

Pasi u degjua, përgjigjet kryetari i Keshillit znj.Donika Bauçi:

Meqenese të dy jeni të pajisur me çertifikatë pronarie dhe është dhënë një vendim gjykatës ,kjo çështje nuk është në kompetencë të Keshillit Bashkiak,për të kundërshtuar vendimin e dhënë duhet t’i drejtoheni Gjykatës.

Për mbledhjen e ardhshme miratimi i projektdokumentit të parë të PBA-së 2023-2025 ,pika 3 e rendit të ditës dhe mbarimi i mandatit të Keshilltarit .

Deklarohet e mbyllur mbledhja.